

VENDIM
Nr. 101, datë 11.2.2026

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 586, DATË 30.8.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PUNËSIMIN E PËRKOHSHËM TË STUDENTËVE TË
EKSELENCËS NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHETETËRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/3, të kreut III, të vendimit nr. 586, datë 30.8.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/4, me këtë përmbajtje:

“2/4. Përgjashtimisht për vitin 2026, për studentët e ekselencës të punësuar me kontratë të përkohshme 1-vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, sipas procedurave të thirrjes së publikuar në dhjetor 2024, afati i kontratës së tyre të shtyhet deri në përfundim të procedurave të punësimit, sipas legjislacionit specifik, që rregullon marrëdhënien e punës në këto institucione.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama